



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
VLORË

Nr.307 Regj. Them  
Datë 11.06.2013

Nr. 307 Vendimi  
Datë 18.06.2013

V E N D I M  
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e përbërë nga :

**GJYQTAR: ERVIN TRASHI**

Asistuar nga sekretare séance Lorena Grabova, sot më datë 18.06.2013 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën penale që i përket:

Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar në gjykim nga Prokuror [REDACTED]

Persona të interesuar:

[REDACTED] i biri [REDACTED] dhe [REDACTED] i datëlindjes 05.12.1971, lindur dhe banues në Vlorë, identifikuar me letërnjoftimin nr. [REDACTED] mbrojtur në gjykim nga [REDACTED]

[REDACTED] i biri [REDACTED] dhe [REDACTED] i datëlindjes 04.02.1986, lindur dhe banues në Vlorë, identifikuar me letërnjoftimin [REDACTED] mbrojtur në gjykim nga [REDACTED]

Objekti:

Konfiskimi i sendeve të sekuestruara:

- a-) "Varkë Plastike" me gjatësi 5.5 m e gjerësi 2 m, ngjyrë të verdhë pa mbishkrim anash dhe pa numër matrikullimi;
- b-) një motorr deti tip "Honda" me fuqi motorrike 130 h.p. me nr serial 2008883016 MAR me ngjyrë gri me të zezë;
- c-) një motorr deti tip "Suzuki" me fuqi motorrike 10 h.p. me nr serial 200788691 NOV ngjyrë e zezë;

Baza Ligjore: Neni 23/3 dhe 29/3 të Ligjit Nr. 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT".

Gjykata, në përfundim të gjyqimit pasi administroi provat shkresore dëgjoi palët në pretendimet përfundimtare, ku prokurori [REDACTED] kërkoi pranimin e kërkesës, ndërsa personi i interesuar, [REDACTED] kërkoi rrëzimin e saj.

Gjykata pasi shqyrtoi dhe bisedoi çështjen në tërësi:

V E R E N

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, më datë 11.06.2013 ora 15.30, është sjellë për gjykim, pranë kësaj gjykate, kërkesa për konfiskimin e mjetit lundrues, që i

përket shtetasit [redacted] të sekuestruar me procesverbalin e datës 28.05.2013 nga oficeri i policisë gjyqësor [redacted]

Në shqyrtimin gjyqësor, bazuar mbi provat shkresore të paraqitura nga pala kërkuese rezultoi se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e materialit të ardhur nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 329 viti 2013 për veprën penale të parashikuar nga neni 23/1 dhe 29/1 të Ligjit Nr. 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT" aktet e të cilit janë në ngarkim të shtetasit [redacted] dhe [redacted]

Nga materialet referuese ka rezultuar se në datë 27.05.2013 në orën 03.30, në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative, Sektori i Shërbimeve Operacionale dhe Hetimit në D.R.K.M. Vlorë, në zonën përballë ish "FNSH", plazhi i vjetër është konstatuar një mjet lundrues i vendosur në karrelë, i cili tërhiqej nga një automjet fuoristrade. Automjeti po lëvizte nga rruga kryesore Vlorë-Zvërnec në drejtim të detit.

Pas këtij konstatimi i është bërë thirrje drejtuesit të mjetit [redacted] për të ndaluar. Shtetasi i mësipërm ka deklaruar se nuk dispononte me vete dokumentet e mjetit lundrues. Ai gjithashtu ka deklaruar se pronar i mjetit lundrues ishte shtetasi [redacted]. Në këtë moment ka komunikuar me të në telefon për të paraqitur dokumentacionin përkatës.

Ka rezultuar se shtetasi [redacted] ka paraqitur dokumentacionin e mjetit lundrues tip "Varkë" me emrin "LUPO" me nr matrikullimi "535-V" me gjatësi 4.4 m, gjërësi 1.7 m, me një motor tip "Yamaha" 25 hp, i pajisur me "Dëshmi Aktësisë së Lundrimit për Mjete të Vogla" nga Zyra e Regjistrimit të Kapitenerisë Vlorë. Mjeti nuk dispononte "Çertifikatë Përdorimi Mjeti Lundrues" nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë, për këtë arsye mjeti lundrues është shoqëruar për verifikim të mëtejshme në Pikën e Kalimit Kufitar Porti Vlorë.

Nga kqyrja që i është bërë mjetit lundrues në datë 28.05.2013 ora 14.00 ka rezultuar se dokumentacioni i paraqitur prej shtetasit [redacted] nuk i përkiste këtij mjeti lundrues. Nga procesverbali i kqyrjes mjeti lundrues është përshkruar: "Varkë Plastike" me gjatësi 5.5 m e gjerësi 2 m, ngjyrë të verdhë, me dy shiritë gome ngjyrë të zezë, anash në të dy krahet, pa mbishkrim dhe pa numër matrikullimi; me një motor tip "Honda" me fuqi motorike 130 h.p. me nr serial 2008883016 MAR me ngjyrë gri me të zezë dhe një mjet tjetër tip "Suzuki" me fuqi motorike 10 h.p. me nr serial 200788691 NOV ngjyrë e zezë;

Nga deklaratimet e shtetasit [redacted] ka rezultuar se ka në përdorim 2 mjete lundruese njërin me emrin "LUPO" të matrikulluar në Kapitenerinë e Portit Vlorë me nr matrikullimi "535-V" të cilën e ka regjistruar në Drejtorinë e Policisë Kufitare Vlorë në vitin 2009, të pajisur me çertifikatë përdorimi mjeti lundrues deri në vitin 2011. Gjithashtu ai deklaroi se ka në pronësi një mjet tjetër lundrues tip "Varkë Plastike" me emrin "MOBI-DICK" me numër matrikullimi "05-V" të regjistruar në vitin 2008 në Kapitenerinë e Portit Vlorë.

Në këto kushte oficeri i policisë gjyqësore, i Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare dhe Migracionit Vlorë, [redacted] duke konstatuar shkelje të neneve 13 pika 4 dhe 29 të ligjit nr 8663 datë 18.09.2000 "Zhvendosja ose përdorimi i mjetit pa autorizim", ka kryer në datë

<sup>1</sup> Me procesverbalin nr 45 datë 28.02.2011 ka ndryshuar emrin nga "Arban" në "Alf". Zyra e Gjëndjes Civile Nr. 2 Vlorë



28.05.2013 sekuestrimin sendit: "Varkë Plastike" me gjatësi 5.5 m e gjerësi 2 m, ngjyrë të verdhë, me dy shirita gome ngjyrë të zezë, anash në të dy krahet, pa mbishkrim dhe pa numër matrikullimi; me një motor tip "Honda" me fuqi motorike 130 h.p. me nr serial 2008883016 MAR me ngjyrë gri me të zezë dhe një motor tjetër tip "Suzuki" me fuqi motorike 10 h.p. me nr serial 200788691 NOV ngjyrë e zezë."

Me vendimin e datës 31.05.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur: "Vleftësimin si të ligjshëm të sekuestrës për sendet e sekuestruara sipas procesverbalit të sekuestrimit datë 28.05.2013."

Për sa më sipër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë pretendon se shtetasit [redacted] dhe [redacted] kanë kryer shkelje të neneve 12 dhe 13 pika 4 të Ligjit Nr. 8663 datë 18.09.2000. Prokuroria pretendon se në zbatim të nenit 23/1 dhe 29/1 të ligjit të sipërcituar, është përcaktuar se mosrespektimi i nenit 12 dhe 13/4 të këtij ligji, përbën kundërvajtje penale dhe shoqërohet me sekuestrimin e mjetit lundrues nga oficeri i policisë gjyqësore.

Mbrojtësi i personave të interesuar [redacted] ka parashtuar në seancë gjyqësore se kërkesa e prokurorisë është e pabazuar në ligj si e tillë duhet rrëzuar. Ai pretendoi se mjeti i sekuestruar nuk ka qënë duke lundruar, por i tërhequr nga një makiç, pas kryerjes së shërbimeve të nevojshme në oficinë. Avokati parashtrroi se mjeti lundrues është i pajisur me gjithë dokumentacionin e nevojshëm për lundrim dhe peshkim pasi ai është regjistruar dhe ka marrë dhe certifikatën e përdorimit të këtij mjeti si dhe licencën e peshkimit.

Nga shqyrtimi i akteve shkresorë të administruara në dosje, Gjykata vlerëson se kërkesa e Prokurorisë duhet të rrëzohet për këto arsye:

Gjykata merr në analizë ligjin Nr. 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT"<sup>2</sup> dhe nenet 270-276 të Kodit të Procedurës Penale.

Në neni 5 të Ligjit 8663/2000 përcaktohet detyrimi i përgjithshëm i mjeteve lundruese, i cili në çdo rast është matrikullimi i tyre në kapitenerinë e portit si dhe regjistrimi në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin.

Neni 6 i ligjit 8663/2000 ka përcaktuar procedurën e matrikullimit dhe lëshimin e lejes së lundrimit. Në pikën 1 të këtij neni përcaktohet: "Kërkesa për matrikullim duhet të paraqitet nga pronari ose nga bashkëpronarët e mjetit lundrues brenda pesë ditëve nga fitimi i së drejtës të pronësisë mbi mjetin lundrues dhe duhet të përcaktojë qëllimin e përdorimit të mjetit, duke i bashkëlidhur dokumentacionin e lëshuar nga Regjistri Detar Shqiptar."

Neni 7 i ligjit 8663/2000 ka përcaktuar procedurën për regjistrimin në zyrën e policisë. Në pikën 1 të këtij neni përcaktohet: "Kërkesa për regjistrim nga pronari ose nga bashkëpronarët e mjetit lundrues duhet të paraqitet zyrës së policisë kufitare, përgjegjëse për territorin, brenda pesë ditëve nga lëshimi i lejes së lundrimit."

Neni 9 i ligjit 8663/2000 ka përcaktuar se brenda 5 ditëve nga kryerja e regjistrimit, zyra e policisë kufitare, i lëshon pronarit certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues.

Nga interpretimi literal i këtyre dispozitave rezulton se pronari i një mjeti lundrues duhet që brenda 5 ditëve nga momenti i blerjes së mjetit, të paraqitet në Kapitenerinë e Portit me

Më poshtë do të citohet ligj 8663/2000



qëllim matrikullimin dhe pajisjen me lejen e lundrimit. Brenda 5 ditëve nga pajisja me leje lundrimi, pronari i mjetit lundruës duhet të paraqesë kërkesën për regjistrimin e mjetit lundruës në zyrën e policisë kufitare përgjegjëse për territorin. Kjo e fundit brenda 5 ditëve nga kryerja e regjistrimit, i lëshon pronarit certifikatën e përdorimit të mjetit lundruës.

Ndërsa neni 12 i ligjit 8663/2000 ka përcaktuar rastin kur mjeti lundruës është matrikulluar dhe regjistruar, por ndryshon vendbazimi i përhershëm i mjetit. Në këtë rast personi që zotëron ose mban, me çfarëdo lojë titulli, një mjet lundruës ose pjesë të tij, duhet të bëjë deklarinimin me shkrim, brenda njëzet e katër orëve nga marrja në zotërim ose në mbajtje, në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin.

Neni 13 pika 4 i ligjit 8663/2000 ka përcaktuar se deri në lëshimin e certifikatës së re të përdorimit, mjeti lundruës nuk mund të zhvendohet nga vendi i ruajtjes, as të përdoret për çfarëdo lojë qëllimi.

Në pjesën e shtatë të këtij ligji të titulluar "Sanksionet" janë parashikuar edhe shkeljet përkatëse që përbëjnë kundërvajtje penale. Në këtë ligj janë parashikuar 12 vepra penale, të cilat kanë specifikat e tyre, përsa u përket anës objektive dhe subjektivit shkelës.

Saktësisht janë të përcaktuara këto vepra penale. Neni 19 "Regjistrimi dhe lëshimi i paligjshëm i certifikatës së përdorimit" Neni 20 "Mospasja e dokumenteve gjatë lundrimit" Neni 21 "Refuzimi për paraqitjen e dokumenteve" Neni 22 "Mosbërja e deklarinimit të importimit" Neni 23 "Mosdeklarimi i zotërimit ose i mbajtjes" Neni 24 "Mungesa e matrikullimit ose e regjistrimit" Neni 25 "Ndryshimi ose falsifikimi i karakteristikave të mjetit lundruës" Neni 26 "Përgjegjësia e fabrikave dhe e kantierëve detare" Neni 27 "Refuzimi i paraqitjes së regjistrave" Neni 28 "Mosdeklarimi i ndryshimeve" Neni 29 "Zhvendosja ose përdorimi i mjetit pa autorizim" Neni 30 "Tejkalimi i numrit të personave që transportohen"

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë pretendon se shtetasit [redacted] dhe [redacted] kanë kryer veprat penale të:

Neni 23 "Mosdeklarimi i zotërimit apo mbajtjes" sipas të cilit është përcaktuar se:

"1. Mosdeklarimi i zotërimit ose i mbajtjes, siç parashikohet në nenin 12, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë) deri në 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundruës.

2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundruës dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

3. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundruës."

Neni 29 "Zhvendosja apo përdorimi i mjetit pa autorizim" përcakton se:

1. Zhvendosja ose përdorimi i mjetit lundruës, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 13, pikën 5 të nenit 18, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë) deri në 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me konfiskim të mjetit lundruës.

2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundruës dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

3. Në çdo rast sekuestron edhe mjeti i përdorur për transportin nga e për në vendin e përdorimit të mjetit lundruës.

4. Gjykata, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundruës.

Gjykata vlerëson se konfiskimi i mjetit është parashikuar në këto dispozita njëkohësisht, si sanksion ndaj kundërvajtjes penale të kryer, por edhe si masë sigurimi pasuror ndaj

Gjykata konstaton se Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar se masat e sigurimit pasuror janë ndarë në sekuestro konservative dhe sekuestro preventive. Neni 270 i K.Pr.Penale ka përcaktuar kushtet e marrjes së sekuestros konservative, sipas të cilës përcakohet: "Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjabë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqe që ligji lejon sekuestrimin e tyre."

Neni 274 i K.Pr.Penale përcakton objektin e sekuestros preventive sipas të cilit: "Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar".

Në analizë të dispozitave të sipërcituara si edhe të nenit 275 të K.Pr.Penale, rezulton se konfiskimi jepet vetëm me vendim përfundimtar, kur sendi ka shërbyer ose ishte destinuar për të kryer një vepër penale ose ka qënë prodhim apo përfitim nga vepra penale.

Nga analiza e mësipërme, gjykata vlerëson se konfiskimi i mjetit lundrues i parashikuar në nenin 23 dhe 29 të ligjit 8663/2000, duhet vlerësuar si sanksion ndaj veprës penale dhe jo si masë në mbështetje të hetimit. Si e tillë për konfiskimin gjykata duhet të shprehet vetëm me vendim përfundimtar të gjykimit të çështjes penale.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata mbështetur në Ligjin Nr. 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT".

#### VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt konfiskimin e mjetit lundrues, që i përket shtetasit [redacted] të sekuestruar me procesverbalin e datës 28.05.2013 nga oficeri i policisë gjyqësor [redacted]
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 10 ditëve, nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit.

U shpall, sot datë 18.06.2013 në Vlorë.

GJYQTAR

ERVIN TRASHI





Vendimi mori forme te prere me vendimin nr. 209 date 19.07.2013 te Gjykatës se Apelit  
Vlore e cila ka vendosur :

- Lënie ne fuqi te vendimit nr. 307 date 18.06.2013 te Gjykatës se Rrethit Gjyqësorë  
Vlore

**KANCELARE**  
**Irma DHIMITRIADHI**

